

DOKUMENTACIONI QË KËRKOHEP PËR TË APLIKUAR PËR TU PAJISUR ME AUTORIZIM ZONË SHËRBIMI E HYRJE-DALJE NË RRUGËT KOMBËTARE.

- Kërkesën për tu pajisur me Autorizim për Hyrje - Dalje apo degëzim me rrugën kombëtare dhe angazhimin për të përballuar të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen.
- Planimetrinë e sheshit të ndërtimit e cila të përmbajë pozicionin topografik, kadastral, pamjen ajrore emërtimin e rruges dhe km ku kërkohet zona e shërbimit. Në planimetri përgjate rrugës të shënohen hyrje daljet fqinje me atë të kërkuar për të gjykuar në vazhdim për distancat ndërmjet tyre.
- Projektin teknik të kryqëzimit të rrugës kombëtare me Hyrje – Daljen, hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 **“Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë** “nenet 2,3, 13,14,15,16,17,18,19,20,22,24,25 si dhe V.K.M nr. 153 datë 07.04.2000 **“Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”** nenet 25,26,27,43,44,59-67. Për zonat e shërbimit (**karburantet**) projekti teknik do të referohet VKM nr.493 datë 22.07. 2014.
- Certifikata e pronësisë me hartën treguese për sheshin e ndërtimit (e noterizuar).
- Leje ndertimi, leje për sheshin e ndertimit, si dhe leje shfrytëzimi (e noterizuar).
- Formulari 1/1 “Lidhja e objektit me infrastrukturen rrugore”.
- Raport Auditimi të sigurisë rrugore, për projektin e hartuar, nga një auditues i certifikuar.

Dokumentacioni dorëzohet 4 kopje pranë zyrës së protokollit.

Faleminderit për bashkëpunimin!